



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”**

**SHPALLJE KËRKESE PËR DONACION**

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullit, të cilit i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas ligjeve në fuqi, i cili ka në fokus të aktivitetit të tij mbrojtjen e jetës, shëndetit fizik dhe mendor të pacientit dhe lehtësimin e vuajtjeve të tij, duke i ofruar një shërbim shëndetësor sa më cilësor dhe dinjitoz.

Me anë të kësaj thirrje, QSUNT dëshiron të kërkojë vëmendjen e publikut lidhur me mundësinë për të kontribuar në përmirësimin e monitorimit të pacientit gjatë trajtimit me burime të rrezatimit jonizues në ambiente të caktuara në QSUNT.

Referuar situatës aktuale në shërbimin e Brakiterapisë, QSUNT kërkon donatorë të mundshëm për të kontribuar në përmirësimin e monitorimit të pacientit gjatë trajtimit me burime të rrezatimit jonizues, për të rritur cilësinë e kontrollit të pacientit dhe ruajtjen e shëndetit të personelit mjekësor. Prania e kamerave për monitorimin e pacientit është e nevojshme në rast të ndonjë lëvizjeje të mundshme nga aplikatorët e brakiterapisë dhe për të arritur lokalizimin me saktësi maksimale. Burimi i rrezatimit që përdoret në brakiterapi duhet të lokalizohet vetëm në qelizat tumorale dhe qelizat e shëndosha që cilësohen si “organet e rrishtit” të ruhen të paprekura.

Duke shpresuar në kontributin tuaj në mbulimin e kësaj, mirëpresim të gjithë të interesuarit.

**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”**